

Takimi i 13 online i projektit SINCERE

Ne vijim te punes në kuadrin e projektit "Sincere" me koordinator universitetin "Fan S. Noli" të Korçës dhe tashmë një prej partnerëve përfaqësues të institucioneve te arsimit të lartë ne rajonin e Ballkanit Perëndimor, Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, më 02.06.2026 u mbajt takimi i 13-të.

Fokusi kryesor i kwtij takimi ishte hartimi i Kornizes se Integritetit Akademik, nje angazhim ky i cili do të përmbushet nga WEBIN dhe do t'u vihet në dispozicion universiteteve partneretë konsorciumit për ta përshtatur me legjislacionin si dhe aktet regullatore ne fuqi në institucionet respektive.

Një çështje tjetër jo me pak e rëndësishme ishte hartimi i moduleve trainuese në kuadrin e Integritetit Akademik si dhe etikës në kërkim. Modalitetet e diseminimit të këtyre moduleve do të jenë online si dhe in-person duke synuar trainimin e një numri të konsiderueshëm staf akademik, staf ndihmës-akademik dhe studentë.

Diskutimet në këtë takim u dhanë zgjidhje edhe problemeve teknike mbi implementimit e software antiplagjaturë, kërkesë kjo imediate në kuadrin e ruajtjes së Integritetit Akademik dhe aplikimit të etikës në kërkim.

